



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

STRATEGJIA PËR PRONËSINË INTELEKTUALE
2010 - 2014

Maj 2010
Prishtinë

Përmbajtja:

I. HYRJE	4
II. NOCIONI I TË DREJTAVE TË PRONËSISË INTELEKTUALE	6
III. STANDARDET NDËRKOMBËTARE DHE EVROPIANE NË FUSHËN E PRONËSISË INTELEKTUALE	6
III. SITUATA AKTUALE	7
2.2 Aktet nënligjore/Udhëzimet administrative	8
V. Qëllimi dhe Synimi	10
1. Qëllimi	10
2. Synimi	10
VI. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE MASAT PËR ARRITJEN E TYRE	11
1. Plotësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës ligjore në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane.....	11
2. Ngritja e Kapaciteteve Teknike të Institucioneve Administruese të DPI-së.....	12
2.1 Zyra për Pronësinë Industriale e Kosoves	12
2.2 Themelimi i Zyrës për të Drejtat Autoriale	14
3. Ngritja e kapaciteteve të institucioneve të zbatimit të ligjit dhe si dhe forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit	14
3.1 Ngritja e kapaciteteve profesionale në institucionet e zbatimit të DPI-së.....	14
3.2 Përforcimi i mekanizmave të zbatimit dhe përmirësimi i bashkëpunimit dhe koordinimit të institucioneve të zbatimit.....	15
4. Themelimi i organizatave për menaxhim kolektiv të drejtave të autorit dhe të drejtave tjera të përafërta, dhe zhvillimi i një grupi të agjentëve për pronësi industriale	16
3. Ngritja e Vetëdijes dhe Edukimi për të Drejtat e Pronësisë Intelektuale	16
4. Aderimi në konventat dhe traktatet ndërkombëtare	Error! Bookmark not defined.
VI. ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I STRATEGJISË	18
1. Roli i sistemit të monitorimit	18
2. Kapacitetet institucionale për monitorim dhe vlerësim.....	18
3. Zgjedhja e treguesve të monitorimit dhe vlerësimit.....	19
4. Instrumentet e monitorimit dhe vlerësimit	19
5. Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit.....	19
VII. PLANI I VEPRIMIT	20
VIII. PRIORITETET DHE PËRGJEGJËSITË	20

Shkurtesat e përdorura

UA	Udhëzimi Administrativ
ZDA	Zyra për të Drejtat e Autorit
ZPI	Zyra Për Pronësi Industriale
KMP	Konventa për Mbrojtjen e Patentave
EPO	Zyra Evropiane për Patenta -
EU	Bashkimi Evropian
KNPI	Këshilli Nacional për Pronësi Intelektuale
GATT	Marrëveshja e përgjithshme për tarifa dhe tregti
PI	Pronësia Intelektuale
DPI	Drejtat e Pronësisë Intelektuale
TI	Teknologjia Informative
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MD	Ministria e Drejtësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
OHIM	Zyra për harmonizimin e tregtisë së brendshme
EPC	Konventa Evropiane për patenta -
PCT	Traktati për bashkëpunimin në patenta
TRIPS	Marrëveshja për aspektet e marrëveshjeve tregtare në fushën e PI
WCT	Konventa e OBPI për të drejtën autoriale
OBPI	Organizata Botërore për Pronësi Intelektuale
ZIT	Zyra e Inspektoratit të Tregut

HYRJE

I.

Duke marrë parasysh se roli i pronësisë intelektuale po zë vend gjithnjë më të madh në tregtinë ndërkombëtare dhe duke ditur rëndësinë e krijimit të një sistemi efikas për mbrojtjen jo vetëm të bartësve të të drejtave të pronës intelektuale por edhe shoqërisë në përgjithësi, Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndërmarrë hapa drejtë hartimit të strategjisë shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të pronës intelektuale që synon krijimin e një infrastrukture moderne përmes ndërtimit dhe fuqizimit të kapaciteteve të saja institucionale dhe ligjore.

Strategjia për Pronësinë Intelektuale e Republikës së Kosovës, është një dokument politik i miratuar nga Qeveria e Kosovës që përcakton synimin dhe qëllimin e Kosovës në fushën e pronës intelektuale, si dhe objektivat strategjike dhe masat për arritjen e këtyre objektivave në nivel shtetëror për periudhën 2010-2014.

Përveç kësaj, Strategjia e PI –se synon të shërbejë si dokument politik që siguron baraspeshën në mes të interesave të krijuesve dhe interesit publik duke parandaluar çfarëdolloj abuzimi me të drejtat që rrjedhin nga prona intelektuale të cilat do ta pengonin ekonominë e tregut dhe konkurrencën e ndershme.

Strategjia për Pronësinë Intelektuale duhet të shihet si një arritje në drejtim të njohjes, administrimit dhe mbrojtjes së të drejtave që rrjedhin nga pronësia intelektuale, të drejta të cilat ushtrojnë një ndikim të fuqishëm në funksionimin e ekonomisë së tregut, si dhe ruajtjes dhe forcimit të rregullave të një konkurrence të drejtë.

Objektivi kryesor i Strategjisë për Pronësinë Intelektuale është përmirësimi i klimës investuese dhe stimulimi i zhvillimit ekonomik, shkencor dhe kulturorë në vend, e cila synon ofrimin e një sistemi të besueshëm dhe stimulues të mbrojtjes së të drejtave të pronës intelektuale përmes zhvillimit dhe avancimit të kornizës ligjore dhe kapaciteteve institucionale, të gjitha këto të orientuara për mbrojtje, mirëmbajtje, zbatim dhe shfrytëzim sa me efikas të pronësisë intelektuale.

Strategjia për Pronësi Intelektuale paraqet edhe një shprehje të vullnetit politik të Republikës së Kosovës për hapjen e rrugëve drejtë aderimit në organizatat dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e Pronësisë Intelektuale.

Kjo Strategji ka vlerën e një platforme shtetërore, që përcakton mënyrën e zhvillimit dhe implementimit të politikave në mënyrë të koordinuar nga grupet e ndryshme të interesit. Kjo konkretizon një nga përpjekjet më të rëndësishme për angazhimin intensiv profesional, vendosjen e dialogut gjithëpërfshirës dhe mirëkuptimin ndërmjet akterëve të ndryshëm, duke u ofruar mundësinë të gjithëve që të rrisin rolin e tyre në mbrojtjen e pronës intelektuale.

Strategjia synon krijimin e një kulture të mirëfilltë të respektimit të pronës intelektuale përmes ngritjes së vetëdijes së shoqërisë Kosovare në lidhje me PI. Ajo po ashtu reflekton një përafrim të plotë me parimet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në zhvillimin e pronësisë intelektuale.

Dokumenti është strukturuar në nëntë kapituj që trajtojnë çështjet sipas kësaj radhe: (1) hyrja, (2) nocioni të drejtave të pronësisë intelektuale, (3) standardet ndërkombëtare dhe Evropiane, (4) situata aktuale, (5) Synimin dhe qëllimin (6) objektivat strategjike dhe masat për realizimin

e tyre, (7) zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi i strategjisë, (8) plani i veprimit, dhe (9) prioritetet dhe përgjegjësitë. Plani i Veprimit i bashkangjitur është pjesë integrale e Strategjisë. Plani i veprimit ofron veprime konkrete për secilin objektiv strategjik të paraparë me këtë dokument. Ai po ashtu parasheh edhe afate kohore, institucione përgjegjëse dhe përkrahëse, buxhetin dhe indikatorë për secilin prej veprimeve.

Hartimi i Strategjisë është fryt i kontributeve të ekspertëve vendor, në veçanti i kontributeve të ekspertëve nga Zyra për Pronësi Industriale dhe nga ana Zyra ndërlidhëse e KE ne Prishtine përmes projektit EUAPO..

II. NOCIONI I TË DREJTAVE TË PRONËSISË INTELLEKTUALE

Pronësia Intelektuale (PI) i referohet krijimeve mendore: shpikjeve, veprave letrare dhe artistike, simboleve, emrave, imazheve, dizajnëve të përdorura në afarizëm¹. Titullarët e këtyre të drejtave mund t'i ndalojnë të tjerët që t'i përdorin krijimet e tyre pa autorizim paraprak, ose mund të lejojnë shfrytëzimin dhe përdorimin e tyre në shkëmbim të kompensimit material për përpjekjet dhe investimet e tyre gjate gjithë krijimtarisë.

Pronësia intelektuale ndahet në dy degë, “pronësinë industriale” dhe “të drejtën e autorit”. Për qëllime të kësaj Strategjie, çdo referencë tek Pronësia Intelektuale duhet të nënkuptohet se bëhet fjalë edhe për pronësinë industriale edhe për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Pronësia Industriale përfshinë të drejtën lidhur me Patentat, dizajnet industrial, markat tregtare dhe markat e shërbimeve, emrat tregtarë, indikacionet (treguesit) gjeografike, varietetet e reja bimore, tipografitë e qarqeve të integruara, dhe mbrojtjen nga konkurrenca e padrejtë.

Të drejtat e autorit janë të drejta që u njihen personave të caktuar për krijimtarinë e tyre në fushën e letërsisë, shkencës dhe artit dhe përfshijnë në mes tjerash: romanet, poezitë, kompozimet muzikore, skulpturat, pikturat, vizatimet, krijimet kinematografike, arkitekturën, koreografinë, fotografinë dhe krijimet tjera të ngjashme. Kjo degë e Pronësisë Intelektuale përfshinë edhe të ashtuquajtura të drejta të tjera të përafërta me të drejtën e autorit; e drejta e artistëve interpretues (këngëtarët, muzikantët tjerë, valltarët, aktorët dhe të tjerët të cilët interpretojnë vepra); producentët e fonogrameve, producentët e filmave dhe organizatat transmetuese.

III. STANDARDET NDËRKOMBËTARE DHE EVROPIANE NË FUSHËN E PRONËSISË INTELLEKTUALE

Pronësia intelektuale është pjese integrale e tregtisë ndërkombëtare, dhe rëndësia e saj sa vjen e shtohet pasi që shfrytëzimi efektiv i dijeve është duke ndikuar gjithnjë e më shumë në prosperitetin ekonomik të popujve. Globalizimi i tregtisë ka sjellë me vete implikime serioze në lidhje me mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave që dalin nga pronësia intelektuale. Duke qenë se këto implikime kanë ardhur si rezultat i dallimeve në legjislacionet kombëtare të vendeve të ndryshme të botës, janë bërë përpjekje të mëdha gjatë viteve të fundit drejtë harmonizimit të legjislacioneve vendore përmes traktateve dhe marrëveshjeve të ndryshme ndërkombëtare dhe regionale. Këto marrëveshje ndërkombëtare përcaktojnë parimet kryesore dhe kërkesat minimale në lidhje me mbrojtjen dhe zbatimin e pronësisë intelektuale të cilat duhet të garantohen në legjislacionet vendore të vendeve nënshkruese.

Si shtet i ri me aspirata që të shndërrohet në një treg të lirë dhe me nevojë për qasje në teknologjitë e reja, Republika e Kosovës ka treguar interesim të lartë të aderoj në standardet ndërkombëtare dhe Evropiane për mbrojtjen dhe eksploatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale përmes adoptimit të ligjeve për PI konform kërkesave të cilat burojnë nga to.

¹ Organizata Botërore për Pronësi Intelektuale (WIPO): <http://www.wipo.int/about-ip/en/>

Standardet ndërkombëtare dhe Evropiane reflektojnë ndryshimet dhe zhvillimet më të reja në fushën e pronësisë intelektuale dhe harmonizimi i legjislacionit të Republikës së Kosovës me këto standarde ndihmon vendin që të jetë në hap me këto ndryshime në sistemet ndërkombëtare të pronësisë intelektuale me synim arritjen e standardeve më të larta të mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale. Duke u nisur nga kjo, institucionet relevante të Republikës së Kosovës do t'i intensifikojnë përpjekjet për bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e pronësisë intelektuale në përputhje me zhvillimet ndërkombëtare. Këto institucione duhet të përkushtohen në përforsimin e bashkëpunimit ndërkombëtar me qëllim të anëtarësimit dhe pjesëmarrjes aktive në organizatat ndërkombëtare dhe Evropiane për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

III.SITUATA AKTUALE

Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën 2009², ka përmendur një progres të kufizuar sa i përket zhvillimit dhe mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale në Kosovë. Pavarësisht këtij fakti, me qëllim të përmirësimit të gjendjes në këtë fushë, janë duke ndërmarrë hapa konkret të cilat mund të përmblihen si në vijim:

1. Korniza Ligjore

Korniza aktuale ligjore ka nevojë të zhvillohet më tej në harmoni me standardet Evropiane dhe ndërkombëtare. Me qëllim të përafrimit të legjislacionit me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane, institucionet e Kosovës kanë ndërmarrë hapa konkret drejt reformimit të legjislacionit të pronësisë intelektuale me kërkesat e kohës. Sot, Republika e Kosovës ka në fuqi një bazë ligjore, që ka nevojë për zhvillim dhe përmirësim të mëtutjeshëm.

2.1 Ligjet e aplikueshme

Ligjet e aplikueshme të cilat e rregullojnë fushën e pronësisë intelektuale në Kosovë janë si vijojnë:

- Ligji Nr. 2004/49 për Patenta i datës 27 Shtator 2004, shpallur nga Rregullorja Nr. 2004/56 e datës 21 dhjetor 2004, ndryshuar nga Ligji Nr. 02/L-100, shpallur nga Rregullorja Nr. 2007/10 e datës 6 Shkurt 2007;
- Ligji Nr. 02/L-45 për Dizajn Industrial i datës 21 Nëntor 2005, shpallur nga Rregullorja Nr. 2006/17 e datës 21 Prill 2006;
- Ligji Nr. 02-L-54 për Marka Tregtare i datës 23 Shkurt 2006, shpallur nga Rregullorja Nr. 2006/38 e datës 28 Qershor 2006;
- Ligji Nr. 2004/45 për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtave tjera të Përafërta, shpallur nga Rregullorja Nr. 2006/46 e datës 24 Gusht 2006;
- Ligji Nr. 02/L-98 për Mbrojtjen e Varieteteve Bimore, shpallur nga Rregullorja Nr. 2008/24 e datës 16 Maj 2008
- Ligji Nr. 2009/03-L-170 për Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale, shpallur me anë të Dekretit të Presidentit DL – 004 – 2010 i datës 8 Janar 2010.

² Raporti i Progresit i Komisionit Evropian

Projekt Ligji për Topografi të Qarqeve të Integruara ka kaluar procedurat qeveritare dhe është prezantuar në Kuvend për Miratim.

2.2 Aktet nënligjore/Udhëzimet administrative

- UA nr. 2007/10 i datës 17.09.2007 Për Procedurat e Regjistrimit të Patentës;
- UA nr. 2007/11 i datës 17.09.2007 Për Përfaqësimin në fushën e të drejtave të pronësisë industriale, i ndryshuar në vitin 2008 ;
- UA nr. 2007/12 i datës 17.09.2007 Për Procedurat e Regjistrimit të Dizajnit Industrial;
- UA nr. 2007/13 i datës 17.09.2007 Për Procedurat e Regjistrimit të Markës Tregtare;
- UA nr. 2007/14 i datës 19.09.07 Për aplikacionet e Patentave, Markave Tregtare, Dizajnit Industrial, Patentave, Markave Tregtare dhe Dizajneve Industriale të njohura të lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij UA;
- UA nr. 2007/19 i 5.10.2007 Për Tarifatat e mbledhura nga Zyra për Patenta.

2. Infrastruktura institucionale

- **Autoritetet e Administrimit të DPI-së dhe roli i tyre në sistemin e mbrojtjes së DPI-së**

- **Zyra për Pronësi Industriale (ZPI)**

Zyra për Pronësi Industriale (ZPI) është themeluar me 19 mars 2007, funksionon si agjenci e pavarur në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI) me përgjegjësi për zbatimin e ligjeve në fushën e patentave, markave tregtare dhe dizajnit industrial. Detyra kryesore e Zyrës për Pronësi Industriale është pranimi i aplikacioneve për regjistrim të patentave, markave tregtare dhe dizajneve industrial, kryerja e ekzaminimeve dhe njohja e të drejtave, si dhe të administrimit dhe publikimit të të drejtave të njohura. Zyra është bërë operacionale me 19 Nëntor 2007 dhe që nga atëherë kjo Zyra ka pranuar diku rreth 20.000 aplikime për regjistrime të objekteve të pronës industriale ku shumica e të cilave kanë të bëjnë me marka tregtare. ZPI për momentin ka gjashtë punonjës dhe ekziston nevoja për rritjen e numrit të punonjësve në mënyrë që Zyra të mund t'i kryejë të gjitha detyrat që rrjedhin nga ligjet.

ZPI luan rol me rëndësi në sistemin e mbrojtjes së DPI-së, dhe është po ashtu përgjegjëse për vetëdijesimin publik për PI.

- **Zyra për të Drejtat e Autorit**

Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Përafërta parasheh themelimin e Zyrës për të Drejtat e Autorit në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Akti për themelimin e kësaj Zyre është hartuar dhe tani pret aprovimin formal të saj. Si detyra të ZDA-së, ligji përcakton ndër të tjera edhe certifikimin dhe mbikëqyrjen e organizatave për menaxhim kolektiv.

Institucionet dhe autoritetet e tjera të përfshira në zbatimin e DPI-së

Me gjithë progresin e bërë deri tani në fushën e pronësisë intelektuale, ekziston akoma nevoja e madhe për ngritjen dhe përfundimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve administrative të institucioneve të zbatimit të të drejtave me qëllim të mbrojtjes sa më efektive të të drejtave të pronësisë intelektuale, si dhe përcaktimin dhe definimin më të qartë të kompetencave të institucioneve përgjegjëse të zbatimit të të drejtave nga kjo fushë. Institucionet dhe autoritetet e tjera me rëndësi të përfshira në zbatimin e DPI-së janë:

- Sistemi Gjyqësor: Ministria e Drejtësisë, Këshilli Prokurorial- Prokurorit dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës - Gjykatat

Sistemi i mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale nuk ka vlerë pa një sistem të efikas gjyqësor që merret me shkeljet e të drejtave të pronësisë intelektuale përmes procedurave gjyqësore.

Neni 41 i Marrëveshjes TRIPS nën obligimet e përgjithshme kërkon nga anëtarët e saj që të sigurojnë procedura të zbatimit të cilat mundësojnë veprime efektive kundër çfarëdo veprë të shkeljes së të drejtave të pronësisë intelektuale të përfshira nga korniza ligjore, përfshirë mjete të shpejta për t'i parandaluar shkeljet dhe mjetet që parandalojnë shkeljet e ardhshme. Ministria e Drejtësisë luan një rol vendimtar në arritjen e këtyre obligimeve duke iniciuar, hartuar dhe/apo ndryshuar ligjet të cilat ofrojnë masa të këtitilla brenda sistemit gjyqësor të Kosovës.

Një kërkesë tjetër e rëndësishme që vjen nga Marrëveshja TRIPS është që procedurat në lidhje me zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale duhet të jenë të drejta dhe të paanshme. Në këtë drejtim, Këshilli Prokurorial i Kosovës siguron që sistemi i prokurorisë në Kosovë është i pavarur, paanshëm dhe profesional. Prokurorët Publik janë të autorizuar dhe të obliguar që t'i ndjekin penalisht shkelësit e veprave penale dhe të ngritin padi në emër të shtetit.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron pavarësinë, profesionalizmin dhe paanësinë e gjykatave të Kosovës.

- Ministria e punëve të brendshme/ Policia e Kosovës

Zyrtarët e policisë mbledhin informata lidhur me shkeljet e DPI-së, kryejnë hetime, marrin dëshmi dhe informojnë prokurorinë përgjegjëse lidhur me shkeljet penale. Aktualisht nuk ka njësi të specializuar për çështjet e DPI-së.

- Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF)/ Doganat e Kosovës

Doganat e Kosovës zbatojnë masat kufitare të përcaktuara në Ligjin NR. 2009/03-L-170 për Masat Doganore të Mbrojtjes së të Drejtave të Pronësisë Intelektuale dhe veprojnë në import, eksport, transit, magazinim doganor, përpunimit të brendshëm të produkteve, mbikëqyrje doganore, importit të përkohshëm të vendosur në zonë të lirë doganore. Andaj, roli i tyre është vendimtar në parandalimin e mallrave që për objekt shkelje kanë pronësinë intelektuale. Njësi për të Drejtat e Pronësisë Intelektuale (NjDPI) është krijuar në kuadër të doganave të Kosovës me datë 01.02.2009. NjDPI vepron në kuadër të Sektorit të Inteligjencës së Doganave të

Kosovës dhe aktualisht përbëhet nga dy zyrtar. Sipas skemës organizative të vitit 2010, ky Njësit parashihet që të shndërrohet në Sektor me çast do të vie edhe te plotësimi i stafit me numër të nevojshëm të stafit doganor.

- **Ministria e Tregtisë dhe Industrisë/ Zyra e Inspektoratit të Tregut**

Autoritetet e Inspektoratit të tregut janë themeluar me anë të Ligjit për Inspektoratin e Tregut (Ligji Nr. 02/L-1 of 23, Mars 2005). Ligji përcakton funksionet inspektuese dhe mbikëqyrëse si dhe operimet dhe autorizimet për inspektorët e tregut të cilët zbatojnë mbikëqyrjet inspektuese. Autoritetet e inspektoratit të tregut kanë kompetenca dhe burime për t'i kontrolluar rregullisht vendet e tregtimit, prodhimit, depot, vendet e punës dhe vendet e tjera ku vihen produktet në shërbim; të organizojnë kontrolle dhe të kërkojnë informacione. Inspeksioni i tregut mund të luaj një rol substancial në parandalimin e shkeljeve të DPI-së.

3. Gjendja aktuale në treg

Sfidë kryesore mbetet heqja nga tregu i Kosovës i mallrave piraterike dhe të falsifikuara siç janë CD-të, DVD-të dhe softuerët e ndryshëm dhe produktet e ndryshme industriale. Edhe pse vetëdija e qytetarëve e Kosovës në lidhje me kuptimin dhe rëndësinë e respektimit të pronës intelektuale sa vjen e shtohet, ekziston nevoja për një vetëdijesim gjithëkombëtar në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e çdo qytetari në fushën e pronësisë intelektuale. Një theks i veçantë duhet t'i kushtohet vetëdijesimit të gjeneratave më të reja, që përbën edhe shumicën e popullsisë së Kosovës, në lidhje me implikimet dhe pasojat e shfrytëzimit jo të drejtë të materialit që mbrohet me të drejtën e pronës intelektuale në internet.

V. Qëllimi dhe Synimi

1. Qëllimi

Qëllimi i Strategjisë për Pronësi Intelektuale 2010-2014 është zhvillimi i një sistemi për mbrojtjen e Pronës Intelektuale në Republikën e Kosovës në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane dhe praktikat e mira. Duke pasur parasysh se sistemi për mbrojtjen e PI-së është faktor i rëndësishëm për rritjen ekonomike dhe është një parakusht për krijimin e një ekonomie bashkëkohore të tregut dhe tërheqjen e investimeve të jashtme, krijimi i një sistemi efikas për mbrojtjen dhe regjistrimin e pronës intelektuale në Kosovë paraqet prioritet në veprimet e Qeverisë së Kosovës si në rregullimin e tregut të brendshëm ashtu edhe në bashkëpunime ndërkombëtare ekonomiko-tregtare.

2. Synimi

Synimi i Strategjisë është krijimi i një sistemi efektiv dhe të qëndrueshëm të për mbrojtjen e Pronës Intelektuale në Kosovë, në funksion të zhvillimit ekonomik, plotësimin e një nga kërkesave të procesit të integrimi Evropiane përmes forcimit të institucioneve për zbatim të ligjit dhe ngritjes së vetëdijes së publikut në Republikën e Kosovës mbi rëndësinë e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të PI-së.

VI. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE MASAT PËR ARRITJEN E TYRE

Objektivat strategjike dhe masat për realizimin e tyre janë të formuluar mbi bazën e rishikimit të situatës dhe potencialit ekzistues në këtë fushë, si dhe ambiciet për të vendosur një sistem për mbrojtjen e pronësisë intelektuale sa më afër sistemeve të vendeve të zhvilluara dhe standardeve ndërkombëtare.

Parimet kryesore të dokumentit të Strategjisë janë të orientuara drejtë:

- (1) Përputhshmërisë me standardet Evropiane;
- (2) Ndjekjes së politikës Evropiane në këtë fushë, dhe
- (3) Ndjekja e përvojave dhe praktikave me të mira të shteteve në rajon.

Qëllim kryesor i strategjik për periudhën 2010 deri 2014 është ngritja e një sistemi për mbrojtjen e të drejtave për PI-në që garanton një regjim efektiv të realizimit të të drejtave në Kosovë, si dhe që ndihmon në krijimin e një ambienti të favorshëm për kreativitetin dhe fuqinë konkurruese të palëve në treg, duke stimuluar krijimin e potencialeve inovative (krijuese) në nivel shteti.

Ky qëllim do të arrihet përmes vënies në veprim të të gjitha elementeve të nevojshme për funksionim normal të sistemit për realizimin e të drejtave të pronës intelektuale: legjislacionit bashkohor ; institucioneve për administrim e të drejtave të objekteve të PI-së, mekanizmave zbatues përmes: procedurave gjyqësore, masave kufitare, veprimeve apo procedurave të mbikëqyrjes së tregut; ofruesve të shërbimeve për mbrojtjen e të drejtave të objekteve të PI-së – përfaqësuesve të patentave dhe markave tregtare si dhe të shfrytëzuesit të sistemit, organizatave për menaxhim kolektive të të drejtave etj. Lidhur me këtë janë identifikuar objektivat strategjike si në vijim:

1. Konsolidimi i mëtejshëm i infrastrukturës ligjore në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane;
2. Ngritja e kapaciteteve teknike të autoriteteve administruese të DPI-së
3. Ngritja e kapaciteteve teknike të institucioneve të zbatimit të ligjit si dhe koordinimi dhe forcimi i bashkëpunimit me shtete.
4. Themelimi i organizmave për menaxhim kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave tjera të përafërta, dhe krijimi i një grupi të agjentëve në fushën e pronës industriale
5. Ngritja e vetëdijes së publikut për respektimin e të DPI
6. Aderimi, Kosovës në institucionet ndërkombëtare të PI dhe ratifikimi i konventave ndërkombëtare të kësaj fushe.

Këto objektiva strategjike do të arrihen përmes veprimeve si në vijim :

1. Konsolidimi i mëtejshëm i infrastrukturës ligjore në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane

Harmonizimi i plotë i ligjeve ekzistuese të PI-së në Kosovë me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane të kësaj fushe është një hap i rëndësishëm drejt integritimit të Kosovës në BE.

Harmonizimi me standardet Evropiane (acquis communautaire) do të jetë përgjigje ndaj kërkesave nga procesi i integritimit në BE, duke siguruar sistemi funksional për njërin nga parimet themelore të ekonomisë së tregut dhe garantimit të investimeve siç është mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të pronës intelektuale, ku një sistem i tillë dërgon drejt suksesit në luftën kundër piraterisë dhe falsifikimeve, fenomene me një shkallë të lartë për ndikimin e tyre negativ në treg.

Korniza ligjore do të rishikohet konform standardeve Evropiane dhe ndërkombëtare, dhe bazuar në këtë synim do të hartohen ligjet e reja të cilat ndryshojnë apo zëvendësojnë ligjet ekzistuese. Se pari do të hartohen ligjet që rregullojnë objektet e PI-së të cilat për momentin nuk janë të mbuluara me ligj, duke i mbushur kështu zbrazëtitë në kornizën ligjore. Procedurat për fitimin e të drejtave për objekte të pronës intelektuale do të thjeshtësohen dhe do të bëhen më të lehta për përdorim, dhe në kuadër të kësaj do të hartohen edhe aktet nënligjore për implementimin e kornizës së ndryshuar ligjore.

2. Ngritja e Kapaciteteve Teknike të Institucioneve Administruese të DPI-së

Për mbrojtjen e të drejtave të pronës intelektuale nevojitet ngritja e institucioneve administruese me infrastrukturë teknike adekuate dhe funksionale. Në mënyrë që të kemi zhvillim dhe promovim të suksesshëm të të drejtave të PI-së përmes mekanizmave institucional, nevojitet që këto institucionet të kenë kapacitete të mjaftueshme teknike dhe të specializuara për kryerjen e veprimeve të përcaktuara me ligj. Përveç kësaj, një pjesë e rëndësishme e ngritjes së kapaciteteve teknike është ofrimi i hapësirës dhe mjeteve të punës dhe organizim adekuat institucional. Aktualisht, siç është paraparë, me legjislacionin në fuqi, institucionet bartëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të pronësisë intelektuale në Kosovë janë; Zyra për Pronësi Industriale e Kosovës dhe Zyra për të Drejta të Autorit .

2.1 Zyra për Pronësinë Industriale e Kosovës

Roli kryesor i Zyrës për Pronësi Industriale është njohja e të drejtave të objekteve të Pronës Industriale. Përveç këtij roli, Zyra për Pronësi Industriale shërben edhe si këshilltar dhe ndihmës i Qeverisë në zhvillimin e politikave me qëllim të stimulimit të potencialit inovativ të kombit, si dhe ngritjes së vetëdijes publikut përmes krijimit të kulturës për respektimin e PI-le në vend. Në mënyrë që ta përmbush rolin e vet, Zyra ka nevojë për burime materiale dhe njerëzore që janë parakusht për kryerjen e funksioneve të veta duke iu përgjigjur njëkohësisht edhe sfidave aktuale.

Masat e nevojshme të cilat duhet që të ndërmerren për funksionalizimin e mëtejme të kësaj Zyre bëjnë pjesë në këto kategori:

- Zhvillimi i Strukturës Organizative;
- Zhvillimi i burimeve njerëzore, dhe
- Ofrimi i bazës së nevojshme materiale.

2.1.1 Zhvillimi i Strukturës Organizative të Zyrës

Me qëllim të kryerjes së të gjitha detyrave të saj, Zyra ka nevojë për një numër të shtuar të punonjësve dhe strukturë të re. Gjatë përcaktimit të numrit të stafit duhet të merret parasysh ngarkesa e punës së Zyrës.

Një strukturë fillestare duhet t'i ketë disa sektor dhe njësi: sektorin e pranimit dhe arkivit-përgjegjës për pranimit, regjistër dhe arkivim të dokumentacionit; sektori për patenta- përgjegjës për ekzaminimin dhe njohjen e patentave; sektori i shenjave dalluese - përgjegjës për ekzaminim, regjistrim të markave tregtare dhe dizajnëve industrial; sektori për shërbime administrative- përgjegjës për mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve të teknologjisë informative, çështje financiare, trajnimeve dhe marrëdhënieve me publikun; sektori juridik dhe marrëdhënie ndërkombëtare - me detyrë për të ofruar asistencë juridike për të gjithë sektorët e Zyrës, zhvillim të kornizës ligjore dhe të siguroj përmbushjen e obligimeve në lidhje me konventat, marrëveshjet dhe aktet tjera ndërkombëtare në të cilat Republika e Kosovës është palë.

Duke pasur parasysh numrin e kërkesave të pranuar për regjistrime të objekteve të pronës industriale- Marka tregtare, dizajnë industriale dhe Patenta gjate dy viteve të kaluara, struktura ekzistuese e Zyrës kërkon së paku 15 punëtorë të rinj me arsim dhe njohuri adekuate për çdo pozitë.

2.1.2. Zhvillimi i Burimeve Njerëzore

Kryerja e detyrave dhe efikasiteti i veprimtarisë së përgjithshme të zyrës kërkon aftësim të vazhdueshëm të punonjësve. Aftësimi do të orientohet drejt zotërimit të njohurive për fusha specifike të PI-së; zotërimit të procedurave të regjistrimit, refuzimit dhe anulimit; përdorimit të mjeteve dhe teknologjisë informative në punët e zyrës; përmirësimin e njohurive të përgjithshme të punonjësve të zyrës, si dhe zotërimin e metodave bashkëkohore të menaxhimit. Zyra duhet ta krijojë një ekip me ekspertë të trajnuar si për nga kualiteti i performancës së aktiviteteve po ashtu edhe për nga shndërrimi i tyre në faktor kyç për trajnime në këtë fushë, trajnimin e përfaqësuesve për PI, nëpunësit shtetëror dhe përfaqësuesit e bizneseve. Trajnimet duhet të zhvillohen në formë të punëtorive periodike seminareve, vizitave studimore dhe trajnimeve në vende të punës.

2.1.3 Ofrimi i Bazës së Nevojshme Materiale

Gjatë kësaj periudhe, ZPI-ja duhet që të disponojë me hapësira të punës dhe pajisje të mjaftueshme, me qëllim të mbajtjes së hapit me standardet bashkëkohore dhe për të qenë në gjendje t'i kryej në mënyrë efektive obligimet dhe detyrat e saj. Përveç zyrave për punonjësit e saj, ZPI-së duhet siguruar edhe objekte të cilat përmbushin kushtet e caktuara për vendosjen e sistemeve të automatizuara për arkiva, për sektorin e pranimit, zyrën pranuese, e cila do të siguronte qasje publike në bazën e të dhënave dhe do të shërbente për dhënie të informatave për publikun nga punonjësit e zyrës.

2.2 Themelimi i Zyrës për të Drejtat Autoriale

Zyra për të Drejtat e Autorit do të luaj një rol me rëndësi në zbatimin dhe mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të përafërta përmes licencimit të organizmave për menaxhim kolektiv, shqiptimit të gjobave administrative, ngritjes së vetëdijes, ofrimit të informatave dhe masave të tjera aftësuese dhe edukative. Menjëherë pas themelimit të Zyrës për të Drejta të Autorit, do të themelohet edhe një Trup Këshillëdhënëse dhe për Ndërmjetësim.

Faza e parë që ka të bëjë me fillimin e funksionimit të zyrës kërkon rekrutimin e një apo dy punonjësve, hapësirë adekuate dhe pajisje për punë.. Numri i stafit mund të rritet varësisht nevojave të kapacitetit të Zyrës.

Qëllimi kryesor i politikave të mbrojtjes të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta në Republikën e Kosovës është garantimi i zbatimit praktik i të drejtave të garantuara me ligj konform kërkesave që dalin nga konventat ndërkombëtare.

Detyrimet që rrjedhin në këtë fushë do të realizohen nëpërmjet:

- Themelimit dhe funksionalizimit sa më të shpejt të Zyrës për të Drejtat e Autorit në kuadër të MKRS-ës;
- Institucionalizimit të marrëdhënieve bashkëpunuese me institucionet shtetërore që ndikojnë në procesin e mbrojtjes dhe respektimit të së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta.
- Rritjes së efikasitetit të luftës kundër piraterisë dhe mallrave të falsifikuara të pronësisë intelektuale nëpërmjet forcimit të mekanizmave ligjor dhe institucional.
- Ngritjes së vetëdijes dhe kultivimit të kulturës për rëndësinë dhe nevojën e respektimit të pronësisë intelektuale në mesin e shfrytëzuesve, në rend të parë komunitetit afarist, të veprave të mbrojtura me të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta
- Licencimi dhe promovimi i organizmave të menaxhimit kolektiv

3. Ngritja e kapaciteteve teknike të institucioneve të zbatimit të ligjit forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit mes tyre

Krijimi i një sistemi për mbrojtjen e DPI është i pakuptimtë nëse titullarët e të drejtave nuk mund t'i zbatojnë të drejtat e tyre në mënyrë efektive. Në mënyrë që të sigurohet një mbrojtje e suksesshme dhe efikase e DPI, masa të veçanta duhet të ndërmerren për ngritjen e kapaciteteve të të gjitha institucioneve të përfshira në zbatimin e DPI. Përveç kësaj, për ta zhvilluar me sukses avancimin dhe mbrojtjen e pronës intelektuale, kërkohet ndërtimi i bashkëpunimit dhe koordinim i mirë si brenda institucioneve ashtu edhe midis sektorëve dhe niveleve të organizimit.

3.1 Ngritja e kapaciteteve profesionale në institucionet e zbatimit të DPI-së

Në mënyrë që të arrihet ky objektivi, do të realizohen një numër i trajnimeve për të gjitha institucionet e zbatimit të DPI-së. Këtu vlen të përmenden ZPI, ZDA, Gjykata, Prokurori, Policia e Kosovës- sektori për krime ekonomike, Inspektorati i Tregut, Doganat e Kosovës-

Modulet dhe materialet e trajnimit do të përgatiten në mënyrë që t'i adresojnë nevojat specifike trajnuese për çdo institucion të përfshirë në zbatim të DPI.

3.2 Përforsimi i mekanizmave - përmirësimi i bashkëpunimit dhe koordinimit të institucioneve të zbatimit të DPI-së.

Ky objektivi do të arrihet me implementimin e aktiviteteve si në vijim:

- Do të analizohen kompetencat e secilit institucion që merr pjesë në procedurën e zbatimit të të drejtave të PI-se, dhe në rast të nevojë, do propozojnë ndryshime në bashkëveprim me institucionin relevant kjo do të bëhet në koordinim me Ministrinë e Drejtësisë, ZPI-se, ZDA dhe institucioneve tjera të zbatimit të DPI-le .
- Autoritetet doganore do të ndërmarrin hapat e nevojshëm për zbatimin e masave doganore në përputhje me ligjin dhe standardet Evropiane lidhur me të drejtat e objekteve të pronës intelektuale përmes kontrolleve në kufi ndaj mallrave që shkelin të drejtat e PI-së.
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë do t'i studiojnë mundësitë për rritjen e kompetencave të Inspektoratit të Tregtisë me qëllim të përfshirjes së tij në luftimin e falsifikimeve.
- Një sistem i shpërndarjes së informacionit për të drejtat e PI-së në fuqi në territorin e Kosovës do të vendoset me qëllim të asistimit të institucioneve të zbatuesve të DPI-le në kryerjen e funksioneve të tyre .
- Institucionet e zbatimit të DPI-le do ta vendosin pika të afërta kontakti për bashkëpunim dhe koordinim me institucionet relevante dhe pjesëmarrësit e tjerë në procesin e DPI;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Këshilli Prokurial i Kosovës (KPK), Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) së bashku me ZPI-në dhe ZDA-në do të angazhohen në organizimin e programeve për aftësim të vazhdueshëm për gjyqtarët dhe prokurorët në fushën e pronësisë intelektuale.

3.3 Përmirësimi i bashkëpunimit dhe koordinimit të institucioneve administruese dhe të zbatimit të DPI-së.

Me qëllim të thellimit të bashkëpunimit dhe koordinimit ndër-institucional Qeveria e Republikës së Kosovës, do ta themelojë **Këshillin Shtetëror për Pronësinë Intelektuale**. Anëtarë të këtij Këshilli do të jenë përfaqësuesit e të gjitha institucioneve të përfshira në procesin e administrimit dhe zbatimit të DPI-ve: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Zyra për Pronësi Industriale, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/Zyra për të Drejta të Autorit, Ministria e Punëve të Brendshme/Policia e Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë/Inspektorati i Tregut, Këshilli Gjyqësor i Kosovës/Gjykatat, Këshilli Prokuroria i Kosovës/Prokurorit, institucione dhe organizatat tjera qeveritare dhe jo-qeveritare.

Këshilli do t'i koordinojë aktivitetet e këtyre institucioneve, do të elaboroj masa dhe veprime për ngritjen e efikasitetit të zbatimit praktik të legjislativitetit të PI, mbikëqyrë dhe kontrollon zbatimin e ligjit në atë drejtim. Një tjetër detyrë e Këshillit do të jetë asistimi në bashkëpunim dhe koordinim ndër-institucional në ngritjen e kulturës së IP dhe ndihmese në ekzekutimin e projekteve të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare.

4. Themelimi i organizmave për menaxhim kolektiv të të drejtave te autorit dhe të drejtave tjera të përafërta, dhe zhvillimi i një grupi të agjentëve për pronësi industriale

Licencimi i organizmave për menaxhim kolektiv të të drejtave të autorit dhe te drejtave të përafërta është një hap shumë i rëndësishëm i cili duhet të ndërmerret menjëherë pas themelimit të Zyrës për të Drejta të Autorit. Organizmat për menaxhim kolektiv duhet të sigurojnë një menaxhim efektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të përafërta, te promovojnë dhe te mbrojnë në mënyrë kolektive të drejtat dhe interesat e autorëve, dhe ngritin profilin e autorëve Kosovar si në nivel kombëtar, po ashtu edhe në nivel ndërkombëtar.

Një element tjetër i rëndësishëm në çdo sistem për mbrojtjen e PI-së janë agjentët apo përfaqësuesit e autorizuar të pronësisë industriale të cilët luajnë rol ndërmjetësues në mes të ZPI dhe shfrytëzuesve të sistemit. Ata luajnë një rol shumë me rëndësi në sistemin e PI-së pasi që ofrojnë asistencë profesionale për personat fizik dhe juridik në çështjet që kanë të bëjnë me pronësinë industriale.

ZPI, së bashku me organizmat përfaqësues te agjentëve të PI-së do të organizojnë forma të ndryshme të trajnimeve në fushën e pronësisë industriale me qëllim të përmirësimit të shkathtësive të agjentëve dhe ngritjes së kualitetit të shërbimeve të ofruara.

5. Ngritja e Vetëdijes se Shoqërisë dhe Edukimi për të Drejtat e Pronësisë Intelektuale

Në Kosovë ekziston një nevojë e madhe për krijimin e kulturës për respektimin e te DPI-le. Qytetari i rëndomtë në Kosovë nuk ka informata të mjaftueshme lidhur me ekzistimin e patentave, të drejtave të autorit ose të markave tregtare. Për këtë arsye konsiderohet e rëndësishë së veçantë ngritja e vetëdijes së shoqërisë në lidhje me rolin dhe rëndësin e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave te pronësisë intelektuale, si dhe rëndësisë së saj për zhvillim ekonomik, mbrojtjen e investimeve dhe ndikimin e saj në ngritjen e mirëqenies së qytetareve.

Zyra për Pronësi Industriale dhe Zyra për të Drejtat e Autorit, do të luajnë një rol parësor në procesin e vetëdijesimit dhe edukimit në lidhje me pronësinë intelektuale. Aktivitetet e këtyre zyrave, do të orientohen në ngritjen e vetëdijes rreth rëndësisë së mbrojtjes dhe respektimit të pronës intelektuale në mënyrë të drejtpërdrejtë, përmes komunikimit të përshtatshëm me publikun dhe palët tjera të interesuara, ndërsa në mënyrë të tërthoret, përmes përkrahjes së aktiviteteve të institucioneve shtetërore dhe grupeve të interesit.

Kontributet e drejtpërdrejta në ngritjen e vetëdijes dhe edukimit do të realizohen përmes:

- Zyra e Pronësisë Industriale e Kosovës do të përgatisë materiale të përshtatshme informative për PI-në, shpërndarjen e tyre te bizneset do ta bëjë përmes formave të përshtatshme duke shfrytëzuar edhe infrastrukturën ekzistuese institucionale ashtu që një nga këto forma mund të jete përmes Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në MTI ku bizneset me rastin e regjistrimit do pajisen edhe me materiale informuese për PI-në.
- ZPI do të vendos marrëdhënie të afërta me asociacionet dhe organizatat e ndryshme të biznesit, duke lidhur marrëveshje bashkëpunimi në fushën e pronësisë intelektuale me qëllim të shpërndarjes së materialeve informative mbi PI-në dhe organizimit të aktiviteteve të përbashkëta.

- Masa të veçanta do të ndërmerren për ta promovuar potencialin shpikës në Kosovë. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë synon inkurajimin dhe mbështetjen e investimeve në shpikje dhe fitim të të drejtave të PI-së. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet sektorëve më me perspektivë të industrisë si dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. ZPI do të vendos kontakte me Agjencinë për NVM për aktivitete të përbashkëta.
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë do të studiojë mundësinë e futjes së Pronësisë Intelektuale si lëndë në plan-programin e Universiteteve, me synim ngritjen e njohurive teorike dhe praktike në këtë fushë.
- Raportime të rregullta për aktivitetet zbatuese dhe sukseseve nga ana e institucioneve të administratës shtetërore në fusha të ndryshme të zbatimit të së drejtave të pronës intelektuale, me mbështetje të përshtatshme të mediave;
- Zyra e pronësisë industriale dhe Zyra për të Drejta të Autorit do të inkurajojnë dhe asistojnë universitetet në formulimin dhe vendosjen e një politike për pronësi intelektuale. Politikat duhet të synojnë ngritjen e vetëdijes në mesin e komunitetit akademik siç janë: studentët dhe mësimmshënësit, si dhe të qarqeve jashtë universiteteve, për rendësin e pronësisë intelektuale dhe mundësitë e shfrytëzimit të saj.
- Promovimi i mundësive nga ana e Qeverisë, përmes Institutit të Kosovës për Administratë Publike, për ofrimin e programeve trajnuese për nëpunës shtetërore relevant me informacione rreth pronësisë intelektuale.

Në vazhdim, kontributet indirekte për ngritjen e vetëdijes dhe edukimit do të realizohen përmes sponsorimit apo inicimit të ngjarjeve që kanë të bëjnë me ngritjen e vetëdijes rreth pronësisë intelektuale, dhe pjesëmarrjes së zyrtarëve të lartë qeveritarë në ngjarje të organizuara nga ana e grupeve të interesit dhe operatoreve ekonomik. Zyra për Pronësi Industriale dhe Zyra për të Drejtat Autoriale do të hartojnë programe gjithëpërfshirëse që kanë të bëjnë me ngritjen e vetëdijes, trajnimin dhe të edukimit, të kategorive shoqërore siç janë studentët, sektorin privat, dhe konsumatorët.

6. Aderimi i Kosovës në institucionet ndërkombëtare të PI-së, dhe ratifikimi i konventave ndërkombëtare të kësaj fushe

Kosova do të ndërmerret të gjitha veprimet e nevojshme për tu anëtarësuar në Marrëveshjen për Aspektet Tregtare të Pronësisë Intelektuale (TRIPS) që administrohet nga OBT. Në fushën e pronësisë industriale, Kosova do të aderojë në ne të gjitha konventat dhe traktatet ndërkombëtare të administruara nga Organizata Botërore për Pronësi Intelektuale ku disa prej tyre janë:

- Konventën që themelon Organizatën Botërore për Pronësi Intelektuale
- Konventën e Bernës për Mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike të vitit 1886
- Konventën e Romës për mbrojtjen e performuesve, prodhuesve të fonogrameve dhe organizatave të transmetimit i vitit 1961
- Traktatin për të Drejta të Autorit

- Traktatin për Performues dhe Fonograme
- Konventën e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale
- Protokollin në lidhje me Marrëveshjen e Madridit në Lidhje me Regjistrimin e Markave Tregtare
- Marrëveshjen e Hagës në Lidhje me Depozitën Ndërkombëtare të Dizajnit Industrial (Akti I Hagës 1960), dhe Akti Plotësuar i Stokholmit (1967)
- Traktati I Budapestit mbi Njohjen Ndërkombëtare të Depozitave të Mikroorganizmave për qëllime të Procedurave të Patentat
- Traktati i Kooperimit në Patenta (PCT)

Aderimi në PCT do ta mundësojë aderimin në Konventën Evropiane për Patenta që do të kishte qenë një hap përpara përafritimit praktik me strukturat Evropiane.

VI. ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I STRATEGJISË

1. Roli i sistemit të monitorimit

Procesi i zbatimit të strategjisë, do të jetë një proces i realizimit të objektivave strategjike, objektivave specifike si dhe aktiviteteve. Monitorimi dhe vlerësimi i realizimit të objektivave dhe efikasitetit të aktiviteteve përkatëse, janë pjesë integrale e strategjisë dhe komponentë kryesorë të procesit të zbatimit të saj. Monitorimi dhe vlerësimi do të shërbejnë për të ndjekur ecurinë e strategjisë, për të matur në proces shkallën e realizimit të objektivave të saj, për të vlerësuar nevojën për ndryshime dhe përcaktuar ato, veçanërisht lidhur me aktivitetet. Procesi i monitorimit do të realizohet nga institucionet përgjegjëse përmes Këshillit shtetror për pronësinë Intelektuale me pjesëmarrjen e gjerë të grupeve të interesit. Dimensionet kryesore të monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë janë:

- Kapacitetet institucionale;
- Treguesit e monitorimit përgjatë dhe në fund të periudhës katër vjeçare;
- Burimet e informacionit dhe instrumentet matëse;
- Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit.

2. Kapacitetet institucionale për monitorim dhe vlerësim

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit, do të shtrihet në të gjitha institucionet bartëse dhe përgjegjëse për realizimin e objektivave të përcaktuara në strategji dhe planin e veprimit.

- Zyra për pronësi Industriale, si bartëse dhe përgjegjëse kryesore për realizimin e objektivave, do të krijojë njësinë e monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë. Kjo Zyre do të monitorojë treguesit më të rëndësishëm që kanë të bëjnë me strategjinë. Në fund të çdo viti, duhet të përgatisë një raport progresi mbi shkallën e realizimit të objektivave i cili do të paraqitet Këshillit shtetëror për Pronësinë Intelektuale.
- Ministrinë e linjës dhe institucionet tjera (MTI- Inspektorati i tregut; MD- KGJK, KPK; MKRS- ZDA; MEF- Dogana; MPB- Polici) do të përgjigjen për monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve që kanë si bartës këto ministri ose institucione në vartësi të tyre, duke përfshirë edhe prokuroritë dhe gjykatat. Këto institucione do t'i informojnë

periodikisht Zyrën Për Pronësi Industriale dhe Këshillit shtetror, në mënyrë që raportet të jenë të unifikuara dhe mbi bazën e këtyre raporteve të përgatitet raporti vjetor.

- Organizatat jo-qeveritare, do të marrin pjesë në monitorimin dhe vlerësimin e strategjisë në tryeza të përbashkëta që do të organizohen nga Zyra për Pronësi Industriale. Në këto tryeza, shoqëria civile do të paraqesë raporte vëzhguese që lidhen me projektet dhe programet që ato kanë realizuar.

3. Zgjedhja e treguesve të monitorimit dhe vlerësimit

Treguesit përfundimtarë:

- Numri i ligjeve dhe akteve nënligjore përkatëse, që kanë hyrë në fuqi pas miratimit të strategjisë;
- Strukturat e krijuara (Zyra, dhe institucionet tjera)
- Numri i marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe të nënshkruara me shtetet dhe organizatat tjera;
- Raportet e monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë,
- Numri i çështjeve të trajtuara nga policia, doganat, prokuroria dhe gjykata inspeksioni i tregut.

4. Instrumentet e monitorimit dhe vlerësimit

- Sistemi i standardizuar i mbledhjes dhe përpunimit të informacionit;
- Të dhënat administrative, statistikore nga ZPI, ZDA, MD, MPB (Policia), MEF (Dogana, ATK), MKRS, MD, KPK (Prokurori), KGJK (Gjykatave);
- Mekanizmat kombëtarë, ndërkombëtarë referues;
- Anketime dhe vrojtme të popullatës mbi shkallën e vetëdijesimit për çështjet e Pronësisë Intelektuale.

5. Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit

Rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit do të shpërndahen për të bërë të njohur progresin në avancimin e të drejtave intelektuale, përkatësisht në arritjen e objektivave strategjike. Pasi të hartohen raportet e progresit, bazuar mbi të dhënat dhe vrojtmet, ato do të shpërndahen ndërmjet përdoruesve të cilët do të jenë:

- Institucionet shtetërore,
- Partnerët ndërkombëtarë,
- Shoqëria civile,
- Mediat, dhe
- Publiku i gjerë.

Përgjegjës kryesor për shpërndarjen e rezultateve është Këshilli shtetëror i pronësisë intelektuale i mbështetur nga Zyra për Pronësi Industriale. Gjithashtu, publikimi i rezultateve

do të bëhet edhe nëpërmjet mediave ose duke organizuar seminare dhe tryeza, për të nxjerrë konkluzione në lidhje me ecurinë e strategjisë.

VII. PLANI I VEPRIMIT

Plani i veprimit është hartuar brenda kornizës së përgjithshme strategjike të përcaktuar në Strategjinë shtetërore të Republikës së Kosovës për Pronësinë Intelektuale. Plani i veprimit ka lidhshmëri me kornizën e përgjithshme të strategjisë, do të përmban:

- Objektivat e strategjike;
- Objektivat specifike;
- Aktivitetet konkrete për realizimin e objektivave;
- Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për arritjen e secilit objektiv dhe aktivitet;
- Kornizën kohore për realizimin e secilit objektiv;
- Burimet e nevojshme financiare për zhvillimin e aktiviteteve.
- Indikatorët apo treguesit për realizimin e secilit objektiv dhe aktivitet.

Plani i Veprimit do të rishikohet në baza vjetore nën mandatin e Këshillit shtetror për Pronësi Intelektuale. Përmes rishikimit do të bëhet rifreskimi i Planit të Veprimit përmes një doracaku pune dhe do të shndërrohet në një dokument të veçantë.

VIII. PRIORITETET DHE PËRGJEGJËSITË

Qeveria e Republikës së Kosovës do t'i obligojë të gjitha institucionet përkatëse, të përmendura si pjesëmarrës në këtë dokument, që të planifikojnë në mënyrë të përshtatshme zbatimin e masave të përmendura brenda planeve të tyre afatmesme, duke përcaktuar prioritetet dhe institucionet përgjegjëse gjatë katër viteve të kësaj periudhe strategjike siç janë përcaktuar në Planin e Veprimit.

